



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRIN	
02 Nr. / Br	30 996 / 25
Nr. l fq. / Br. st	1
Data: / Datum	04.07.25
VUSHTRRI - VUÇITRIN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

02.Nr. 769/25 Kryetari
DT. 04.07.2025

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, me 28/04, qershor 2008), si dhe 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet shfrytëzimi i oborreve të shkollave në qytet për parkim pa pagesë të veturave të bashkatdhetarëve tanë të ardhur nga diaspora për pushime të verës në këtë vit, si në vijim:
 - 1.1 SHMU 2
 - 1.2 SHF "Mustafë Venhari"
 - 1.3 SHF "Naim Frashëri"
 - 1.4 SHMT "Lutfi Musiqi"
2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim në bashkëveprim me drejtorët e shkollave të cekura në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe do të vlej për muajt korrik dhe gusht 2025.

Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Arsim
- QSHQ
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITR	
Nr. / Br.	31612/25
Nr. i fq. / Br. st.	- 1 -
Data: / Datum:	08.07.25
VUSHTPARI - VUÇITR	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

02Nr. 763/25
Datë, 08.07 2025

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, dhe nenin 2 të Rregullores (KKV) Nr.01/22, nr. protokollit 157/22, datë 30.06.2022 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (KKV) Nr. 03/2020 datë 27.02.2020 për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat, Kryetari i Komunës merr këtë:


V E N D I M

1. Lejohet subvencionimi i fermerëve të Komunës së Vushtrrisë me nga 0.05 € (pesë cent) për litër qumësht të dorëzuar në pikat grumbulluese ose direkt në qumështore.
2. Pagesa të bëhet për 101 (njëqind e një) fermerë të komunës së Vushtrrisë të cilët janë të përfshirë në listën e Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, bashkëngjitur në shtojcë të këtij vendimi, e që janë përfitues të këtij subvencioni. Sasia e qumështit që subvencionohet: 1527648 litra, vlera për pagësë e subvencionit: 76,382.40 € (shtatëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e tetëdhjetë e dy euro e dyzet cent).
3. Pagesat të kryhen nga mjetet buxhetore (subvencione dhe transfere) të Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
- QSHQ
- Arkivit.



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

02Nr. PB. 797/25
Datë, 23.07 2025

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M PËR THEMELIM TË GRUPIT PUNUES

1. Themelohet grupi punues për implementim të projektit "Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor.
2. Në përbërje të grupit punues caktohen:
 - 2.1 Xhavit Mehmeti, koordinator – zyrtar kryesor për projektin
 - 2.2 Mirjeta Duraku, zëvendëskoordinatore
 - 2.3 Floriana Lëku, anëtare
 - 2.4 Liridon Hajdini, anëtar
3. Grupi punues do të zhvilloj aktivitetet e parapara me këtë projekt si dhe në pajtim me dispozitat e Rregullores së MF Nr. 04/2017 dhe Metodologjinë e LOD.
4. Mandati i grupit punues është 4 vite, aq sa do të zgjas projekti.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit



Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:

- Antarëve të grupit punues
- QSHQ
- Arkivit